



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 36811 Prot.

Tiranë, më 1.12.2021

Lënda: *Përcillet ftesa për pjesëmarrje në momentin e organizimit të shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së, që do të funksionojë përgjatë vitit 2022.*

Drejtuar: **AMBASADËS SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**
DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË TIRANË

Tiranë

I/E nderuar,

Siç dhe mund të jeni në dijeni, Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemin të drejtësisë”, të ndryshuar, ka vendosur të hedhë shortin për zgjedhjen e anëtarëve të **Këshillit të Emërimeve në Drejtësi** që do të funksionojë përgjatë vitit 2022.


Shorti do të zhvillohet ditën e premte, **datë 3 dhjetor 2021, ora 11:00**, në sallën “Skënderbej”, në Institucionin e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1 Tiranë.

Presidenti i Republikës, SH.T.Z Ilir Meta, në vijimësi të traditës dhe praktikës së deritanishme, ka vlerësuar që të ftojë nga një përfaqësues të misioneve tuaja të ekspertizës që mbulojnë çështjet e drejtësisë, për të qenë të pranishëm në momentin e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED-së (2022).

Lutemi përgjelljen e të dhënave identifikuese të përfaqësuesit që do të ndjekë hedhjen e shortit sipas kësaj ftese.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Ornela Zonja